



INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN, MINISTRI HASANI TAKON "MIQTË E BALLKANIT PERËNDIMOR"

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, priti në një mëngjes pune përfaqësuesit e vendeve të formatit "Miqtë e Ballkanit Perëndimor" të akredituar në Tiranë. Në fokus të diskutimeve ishte avancimi i procesit të integrimit të Shqipërisë dhe vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian.



BRUKSEL, 19 NËNTOR 2024 – SHQIPËRIA DHE BE MIRATUAN PARTNERITETIN E SIGURISË DHE MBROJTJES.

Ky kuadër i ri politik krijon një platformë për dialog dhe bashkëpunim të zgjeruar për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, duke reflektuar vendosmërinë e të dyja palëve për të punuar së bashku për të adresuar sfidat e përbashkëta të sigurisë në një mjedis global gjithnjë e më kompleks. Partneriteti i miratuar i Sigurisë dhe Mbrojtjes mbështet në këtë bazë të fortë, duke hapur rrugën rritjes së bashkëpunimit në fusha kyçe.



PRESIDENCA SHQIPTARE E CEI, MINISTRI HASANI: PRIORITET, INTEGRIMI I BALLKANIT PERËNDIMOR

Shqipëria përfundoi presidencën njëvjeçare të Nismës së Evropës Qendrore, (CEI). Në takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të CEI, të mbajtur në Tiranë, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, nënvizoi se Shqipëria në presidencat e saj gjatë vitit 2024: Nisma CEI, BSEC apo SEECP ka bërë përpjekjet më të mirapër të çuar përpara bashkëpunimin rajonal, rritjen ekonomike, dialogun parlamentar dhe lehtësimin e procesit të integrimit në BE.



MINISTRI HASANI TAKON KRYETARIN E OSBE-SË: MALTA MBËSHTETËSE E VAZHDUESHME E SHQIPËRISË NË BE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, priti në një takim Kryetarin e rradhës së OSBE-së, Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin për Punët e Jashtme, Çështjet Evropiane dhe Tregtinë të Maltës, Ian Borg. Ministri Hasani vlerësoi punën e palës malteze në krye të OSBE-së. Dy bashkëbiseduesit u ndalën edhe në mbështetjen e vazhdueshme të Maltës ndaj axhendës së integrimit evropian të Shqipërisë.



DIALOGU I MESDHEUT, MINISTRI HASANI: MË SHUMË BASHKËPUNIM EKONOMIK MES BALLKANIT PERËNDIMOR DHE BE

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani mori pjesë në edicionin e 10-të të Konferencës Ndërkombëtare "Dialogu i Mesdheut 2024" që u mbajt në Romë, ku u diskutua mbi rolin kyç të Ballkanit Perëndimor në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Mesdheut. Në panelin "Roli i Ballkanit Perëndimor në Sigurinë e Mesdheut", Ministri Hasani theksoi nevojën për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe energjetik mes vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian.



DITA E ALFABETIT, MINISTRI HASANI: VËMENDJE MAKSIMALE PËR GJUHËN SHQIPE NË DIASPORË

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani deklaroi se ruajtja e identitetit kombëtar përmes arsimit dhe gjuhës amtare, promovimi i trashëgimisë kombëtare dhe mbrojtja e të drejtave themelore, duke lehtësuar integrimin efikas në vendin pritës janë prioriteti i punës së përfaqësive diplomatike dhe konsullatave shqiptare në botë. I ftuar në Kuvendin Kombëtar për Gjuhën Shqipe, "Sfidat e Gjuhës Shqipe në shekullin XXI", ministri Hasani tha se përmes politikës së jashtme synohet të identifikohen, adresohen dhe zgjidhen problematikat me të cilat diaspora përballet.



MINISTRI HASANI: FUQIZIMI I GRUAS, THELBËSOR PËR TË ARDHMEN E QËNDRUESHME

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani mori pjesë në konferencën "Gruaja, Paqja, Siguria," ku u diskutua roli thelbësor i grave dhe vajzave, në proceset vendimmarrëse për paqen dhe sigurinë. Ministri Hasani nënvizoi angazhimin e Shqipërisë ndaj agjendës mbi gratë, paqen dhe sigurinë, dhe avancimit të të drejtave të grave në vendimmarrje.



SHQIPËRIA RAPORTON NË KËSHILL: TË FOKUSUAR NË RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Shqipëria raportoi përpara Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara në sesionin e 47-të Grupit të Punës së Rishikimit Periodik Universal (UPR), që u zhvillua në Gjenevë, më 4 nëntor 2024. Në fjalën e saj, Zëvendësministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Megi Fino, e cila kryesoi delegacionin shqiptar nënvizoi qëndrimet e Shqipërisë ndaj mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.



SHQIPËRIA OFRON NJË KONTRIBUT VULLNETAR PËR UKRAINËN NË KËSHILLIN E EVROPËS

Shqipëria ka ofruar një kontribut prej 30 mijë eurosh, në mbështetje të Planit të Veprimit të Këshillit të Evropës për Ukrainën, "Rezistencë, Rimëkëmbje dhe Rindërtim" 2023-2026. Ky kontribut vjen në vijim të angazhimeve tona të vazhdueshme në mbështetje të Ukrainës dhe përpjekjeve të saj për të mbrojtur vlerat e përbashkëta demokratike dhe të drejtat e njeriut.



TAKIMI I DYTË I DREJTORËVE POLITIKË TË PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT TË EVROPËS JUGLINDORE (SEECP)

Në takimin e dytë të Drejtorëve Politikë të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), pala shqiptare konfirmoi sërish rolin aktiv të Shqipërisë në këtë nismë por edhe përtej rajonit, duke synuar vazhdimin e bashkëpunimit për paqen, stabilitetin, sigurinë, zhvillimin ekonomik, politik dhe social të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë takimit të dytë të Drejtorëve Politikë u prezantuan aktivitetet që kryesia e Shqipërisë ka parashikuar të zhvillojë gjatë vitit 2024 dhe 2025.